



**Procesverbal i Dëgjimeve për
Buxhetin
e vitit 2022 dhe Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB)
2022-2024
në
Opterushë**

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024, u publikua me datë: 17.06.2021 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitit-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> dhe <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Raspored-Javnih-Rasprava-za-Budzet-i-Srednjorocni-Okvir-Budzeta-Opstine-Orahovac-za-2022-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

*Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komunë, Rregullores Komonale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: **06.07.2021** deri me datë: **16.07.2021** nën organizimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) do të organizohen pesëmbëdhjetë (15) dëgjime publike buxhetore me qytetarë, për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për pesëmbëdhjetë (15) dëgjimet buxhetore në vendbanimet e komunës së Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitit-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> më datë: 17.06.2021.

Poashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar me kohë banorët e secilit vendbanim rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në fshatin Opterushë u publikua më datë: 05.07.2021 në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/07/Njoftim-per-degjim-publik-per-buxhetin-e-vitit-2022-dhe-KAB-in-2022-2024-me-banor-te-fshatrave-Opterushe-Zoqisht-Retije-dhe-Retije-e-Poshtme.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK NË OPTERUSHË

Dëgjimi buxhetor me banorë të fshatrave Opterushë, Zoqisht dhe Retijë dhe Retijë e Poshtme, u mbajt më 12.07.2021 me fillim në orën: 19:10, në ambientet e SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në Opterushë.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga KPF-ja dhe zyrtar komunal ishin: 10

- Femra ishin: 3
- Meshkuj ishin: 7

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 13

- Femra ishin: 0
- Meshkuj ishin: 13

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimin e shpalli të hapur kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Afrim Dina.

Afrim Dina: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në pika të shkurtëra do ta paraqes buxhetin e vitit 2022. Buxheti për vitin 2022 do të jetë 15,053,660.00 Euro, kurse Investimet Kapitale kapin vlerën 4,815,786.00 Euro.

Sugjeroj që ju si kryetarë të fshatrave, kërkesat tuaja t’i dërgoni të protokoluara në Komunë, pastaj ato shpërndahen nëpër drejtori të caktuara. E di që barra kryesore ju bie juve si kryetarë, që pas thirrjes publike juve ju duhet të dakordoheni që të paraqisni ato kërkesa që ju i shihni si më prioritare karshi tjerave.

Enver Kabashi, kryetar i fshatit Zoqisht: Përshëndetje për ju të pranishëm, i nderuar kryesues dhe ju anëtarë të KPF.

Kërkesat e fshatit **Zoqisht** janë:

- Vazhdimi i rregullimit të lumit
- Rregullimi i kanalizimit në dy lagje
- Prania e mjekut në fshat dy herë në javë
- Ndërrimi i trafos-zhvendosje
- Furnizimi me ujë të pijes nga sistemi Radoniqi

Skender Krasniqi, Kryetari i këshillit të fshatit Opterushë: Përshëndetje për të pranishmit, faleminderit për punët e mira që keni kryer por presim edhe shumë të tjera.

Kërkesat e fshatit **Opterushë** janë:

- Rregullimi i ujit të pijës
- Evitimi i problemit me energji elektrike
- Ndërrimi i dytë i AMF-së në fshat
- Rregullimi i kanalizimit
- Hapja e kanalit kullues në një rrugë
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore
- Kubëzimi i rrugëve në disa lagje dhe
- Rregullimi i ndriçimit publik

Mirsad Qehaja, kryetar i këshillit të fshatit *Retijë e Poshtme*: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Unë kërkesat para disa dite i kam dërguar të protokoluara në Komunë por po i paraqes edhe këtu.

Kërkesat e fshatit **Retijë e Poshtme** janë:

- Mbjellja e drunjve dekorativ
- Kubëzimi i rrugëve
- Rregullimi i rrugëve fushore
- Rregullimi i ndriçimit publik
- Rregullimi i fushave sportive
- Renovimi i objektit të shkollës
- Rregullimi i parkut dhe ngjyrosja e rrethojave të varrezave.

Mbledhja përfundoi në orën: 19:45

Blerta Gashi

*Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e dëgjimeve,
konsultimeve dhe takimeve publike*

Rahovec,
gusht 2021